



REPUBLIKA E KOSOVËS
Drejtoria e Inspektionit
Glllogoc, me 02.07.2019



RAPORT PËR MUAJIN QERSHOR 2019

Gjatë muajit Qershor janë bërë inspektime sipas lëmive përkatëse duke filluar nga shqyrtimi i kërkesave të qytetarve në të gjithë sektoret, pastaj është vazhduar me inspektime në teren sipas detyrave dhe agjendës ditore për secilin sektor të përcaktuar kërkesat e qytetarëve dhe menaxhmenti i D.I.

Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili sektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Sektori Sanitar

Gjatë muajit qershor me rëndësi të veçantë janë inspektuar qendrat e mjeksisë familjare në Komunën e Drenasit, gjatë këtyre inspektimeve është konstatuar një gjendje mesatare higjenike dhe shifet se në shumicën prej tyre nuk i plotësojnë kushtet tekniko-sanitare për punë.

Për gjendjen e përgjithshme në këto qendra është raportuar në veçanti duke dhënë edhe rekomandimet e duhura sipas normave sanitare.

Në këtë muaj është vazhduar me inspektimin e subjekteve afariste hoteliere rreth kushteve higjenike dhe sanitare, në ato subjekte që kemi hasur në parregullësi është urdhëruar për përmirësim të tyre, gjithashtu janë ri - inspektuar ato subjekte që ju ka kaluar afati për përmirësim të parregullsive duke marrur të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit në fuqi.

Po ashtu në këtë muaj kemi shqyrtuar 4 kërkesa për pëlqim sanitar në ushtrimin e veprimtarisë, prej tyre dy janë refuzuar pasi që nuk i kanë plotësuar kushtet sanitare (subjekte afariste hoteliere), ndërsa dy prej tyre (subjekte shëndetsore) janë pajisur me pëlqim, pastaj është shqyrtuar edhe një ankesë e palës.

Sipas informatës nga IKSHP dhe ankesën e konsumatorve, me datë 21.06.2019 është realizuar aksion për ndalim të automjeteve kombi-bus të cilët bëjnë transportin e udhëtarve me dyshimin për transport të produkteve të mishit brenda tyre në mënyrë ilegale dhe me këtë rast janë konfiskuar sasi prej 13 kg.

Sektori i Ndërtimit

Janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale, pastaj është inspektuar shtrirja e rrjetit të KEDS-rreth vendosjes së shtyllave dhe kabllave elektrike, e kjo është bërë në bazë të ankesave të shumta të bëra nga banorët lidhur me vendosjen e shtyllave elektrike. Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar procesverbale të inspektimit, aktvendime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave.

Sektori i Komunikacionit

Janë bërë inspektime të transportuesve legal dhe atyre ilegal , por vlen të theksohet se gjatë këti muaji kemi patur mungesë të theksuar të asistimit nga policia , sipas tyre për shkak të numrit të vogël të pjestarve të policisë, por në momentet kur ka patur asistim të policisë kemi inspektuar transportuesit ilegal dhe janë marr masa konform ligjit.

Sektori i Tregut

Janë inspektuar bizneset të cilat kanë ekspozuar artikujt jashtë lokali, është bërë shqyrtimi i kërkesave për dhënjën e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë, kontrollimin e artikujve ushqimor dhe afatet e përdorimit, lokalet që ushtrojnë veprimtarinë e që nuk janë të paisura me pëlqime për ushtrim të veprimtarisë të pajisen me to, brenda afatit që i është dhënë me procesverbal.

Sektori i Mjedisit

Nga mjedisi është bërë shqyrtimi i kërkesave të palëve.

Në bashkëpunim me DSHPE dhe KRM “Pastrimi” në Drenas janë bërë inspektime në fshatin Verboc dhe Komoran , për banorët që nuk janë në sistem të menaxhimit të mbeturinave .

Gjatë këti inspektimi kompania i ka pajisur me kontinjer banorët që nuk kanë qenë në sistem , ndërsa ata të cilët nuk kanë pranuar ju është hartuar procesverbal.

Është bërë inspektim rutinor në mjedis për marrjen e masave për ndonjë parregullsi eventuale.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Qershor, 2019

Sektori	Procesverbale	Aktvendime	Gjeba mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Njoftime	Raporte	Kërkesa	Kallxime penale	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
Sanitari	34	2	1	0	0	2	0	0	0	0	4	0	0	13 kg.mish
Treg	29	4	3	0	0	0	0	0	4	0	4	1	0	0
Komunikacion	11	0	4	0	0	0	0	20	1	0	1	0	2	0
Ndërtim	11	0	0	0	0	0	3	2	5	0	5	0	0	0
Mjedis	14	0	2	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0
Totali	99	6	10	0	0	2	3	22	11	0	15	1	2	13

Korrik , 2019

UD shef në D.I